

“NE BESOJMË NË ATË QË BËJMË”

PËRTEJ BARRIERAVE

Raporti vjetor

2025



BEYOND BARRIERS
—We believe in what we do—

Përmbajtja



- | | |
|--|---|
| 01. Fjalë përshëndetëse | 06. Projektet Ndërkombëtare |
| 02. Rreth Përtej Barrierave | 07. Projektet Kombëtare |
| 03. Njihuni me Ekipin | 08. Projektet Lokale |
| 04. Momentet Kryesore & Aktivitetet | 09. Pika e Kontaktit për E+ & ESC në Shqipëri |
| 05. Publikimet & Kurset e Mësimit Elektronik | 10. Korpusi Evropian i Solidaritetit (ESC) |

Shënim: Për shkak të kufizimeve të hapësirës, ky raport nuk pasqyron të gjithë fushëveprimin e aktiviteteve tona në vitin 2025. Ai ofron një përzgjedhje përfaqësuese të nismave dhe arritjeve kryesore. Për një pasqyrë gjithëpërfshirëse, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: www.beyondbarriers.org

Fjalë Përshëndetëse nga Drejtoresha Ekzekutive

Të dashur miq, partnerë dhe kolegë,

Viti 2025 ka qenë një tjetër vit domethënës për Përtej Barrierave, një vit rritjeje, mundësish të reja dhe mbi të gjitha, angazhimi të vazhdueshëm ndaj të rinjve dhe komuniteteve me të cilat punojmë.

Gjatë këtij viti, kemi përfshirë më shumë se 1,100 të rinj, kemi realizuar 65 aktivitete, kemi zgjeruar punën tonë në 11 qarqe të Shqipërisë dhe kemi forcuar bashkëpunimin me partnerë në më shumë se 20 shtete. Megjithatë, përtej këtyre shifrave, ajo që ka më shumë rëndësi për ne është ndryshimi që krijohet përmes çdo mundësie: një i ri që fiton më shumë vetëbesim, zhvillon një aftësi të re, bën zërin e tij të dëgjohet apo bëhet më aktiv në komunitetin e vet.

Jam veçanërisht krenare që gjithëpërfshirja vazhdoi të mbetet në zemër të punës sonë. Nga programet në mbështetje të të rinjve me aftësi të kufizuara, te pjesëmarrja rinore, vullnetarizmi, të mësuarit digjital, veprimi për mjedisin dhe mobiliteti ndërkombëtar, kemi vazhduar të krijojmë hapësira ku të rinjtë mund të mësojnë, të marrin pjesë dhe të udhëheqin.

Aktivitetet tona në kuadër të Korpusit Evropian të Solidaritetit u zgjeruan gjithashtu përtej Tiranës, duke sjellë mundësitë e vullnetarizmit dhe bashkëpunimit evropian më pranë komuniteteve lokale në Shqipëri.

Asgjë nga këto nuk do të ishte e mundur pa ekipin tonë të përkushtuar, vullnetarët, partnerët, institucionet, donatorët dhe mbi të gjitha, të rinjtë që vazhdojnë të frymëzojnë punën tonë. Teksa shohim drejt së ardhmes, mbetemi të përkushtuar për të hapur mundësi të reja, për të kapërcyer barrierat dhe për të ndërtuar së bashku një shoqëri më gjithëpërfshirëse.

Ana Mullanji
Drejtoresha Ekzekutive



Ana Mullanji

Drejtoresha Ekzekutive

Rreth Përtej Barrierave

Shoqata Përtej Barrierave (BBA) është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe aftësitë përmes edukimit joformal. BBA është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus+ YIA dhe Korpusi Evropian i Solidaritetit (ESC) të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

Misioni ynë është promovimi i përfshirjes, shanseve të barabarta dhe një cilësie më të mirë jetese për të gjithë të rinjtë, si dhe mbështetja e themeleve për ndërtimin e një shoqërie më të mirë për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

7 SHTYLLAT TONA

Programet tona strategjike që fuqizojnë të rinjtë dhe ndëtojnë komunitete **gjithëpërfshirëse, inovative dhe më të drejta.**



**EDUKIMI PËR TË
DREJTAT E
NJERIUT**



**PËRFSHIRJA DHE
DIVERSITETI**



PUNA RINORE



VULLNETARIZMI



**DIGJITALIZIMI DHE
INOVACIONI**



**PJESËMARRJA RINORE
DHE QYTETARIA
AKTIVE**



**PUNËSIMI DHE
SIPËRMARRJA**

Njihuni me Ekipin



ANA MULLANJI

DREJTORESHË
EKZEKUTIVE



SILVIA DERVISHI

MENAXHERE
PROGRAMESH



JOANA RISTA

PKOORDINATORE
PROJEKTESH
(PROJEKTET
EVROPIANE)



**RAFAELA
MBORJA**

KOORDINATORE E
PROGRAMIT ESC



ALESIA DODAJ

KOORDINATORE
PROJEKTESH
(PROJEKTET LOKALE)



ROEL RAPI

KOORDINATOR
LOKAL I PROGRAMIT
ESC



INA TOPI


MENAXHERE
FINANCIARE

Pikat kryesore

• Aktivitetet

PJESËMARRËS TOTAL	KOMBËTARË/ LOKALË	NDËRKOMBËTARË
1101+	1041+	60
NR. I PROJEKTEVE	NR. I AKTIVITETEVE	NR. I PARTNERËVE AKTIVË TË ESC
9	65	10


Në vitin 2025, BBA arriti mbi 1100 të rinj përmes aktiviteteve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale, me 60 pjesëmarrës që iu bashkuan mundësive ndërkombëtare. Përgjatë 9 projekteve, ne zbatuam 65 aktivitete dhe arritëm mbi 450,000+ njerëz në internet.



BBA zhvilloi aktivitete gjatë gjithë vitit 2025, me periudhat më të ngarkuara në pranverë dhe vjeshtë. Maji dhe Tetori patën nivelet më të larta të aktivitetit dhe angazhimit, ndërsa Marsi shënoi një periudhë më të qetë në kalendarin tonë të programeve.

Pikat kryesore

- Shtrirja Rajonale



Kjo hartë ilustron partneritetet e projekteve të Përtej Barrierave në Europë. Në vitin 2025, aktivitetet tona angazhuan partnerë në mbi 20 vende, duke përfshirë nisma kryesore në Shqipëri, Itali, Greqi, Turqi, Mal të Zi e më gjerë. Ky rrjet rajonal forcon bashkëpunimin rinor dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në mbarë Ballkanin Perëndimor dhe BE-në.

Pikat kryesore

- Shtrirja Kombëtare



Harta kombëtare pasqyron praninë e zgjeruar të Përtej Barrierave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2025, duke përfshirë të rinj dhe aktorë lokalë në 11 nga 12 qarqet e vendit. Kjo shtrirje e gjerë gjeografike u mundësua kryesisht përmes projekteve të financuara nga RYDE dhe IPA, të cilat përfshinë bashkëpunimin me bashki, institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe të rinj në këto zona.

Përmes këtij bashkëpunimi, BBA forcoi partneritetet në nivel lokal dhe zgjeroi aktivitetet e saj për angazhimin qytetar, fuqizimin e të rinjve, aftësitë digjitale dhe ndërgjegjësimin mjedisor edhe përtej qendrave kryesore urbane.

Pikat kryesore

- Financat

*BUXHETI I PËRDORUR PËR
AKTIVITETET E BBA-SË
NË 2025:*



€ 322.983
NË EURO

Pikat kryesore

- Roli si ESC hosting

Ditë mobiliteti gjithsej

4,132

Vullnetarë të pritur gjithsej

85


Mobilitete gjithsej (kombëtare)

62


Qytete pritëse

3

Llojet e mobilitetit — kombëtare (Tiranë, Korçë, Sarandë)



Vullnetarë sipas kombësisë — kombëtare (85 gjithsej)



Vullnetarë të pritur sipas qytetit

☐ Tiranë

Qendra kryesore pritëse — 54 mobilitete në të gjitha llojet

☐ Korçë


4 vullnetarë afatshkurtër nga Franca

☐ Sarandë

4 vullnetarë afatshkurtër nga Franca

Pikat kryesore

- Online Reach



Shtrirja jonë në rrjetet sociale vazhdoi të rritet në vitin 2025, duke kaluar nga 300,000 në vitin 2024 në pothuajse 450,000, pra një rritje vjetore prej afërsisht 50%. Kjo tregon forcën e qëndrueshme të pranisë sonë digjitale dhe ndikimin e fushatave tona të vazhdueshme të fokusuara te të rinjtë.

KANALET TONA:



Facebook

facebook.com/PertejBarrierave



Instagram

instagram.com/beyondbarriersngo



Website

www.beyondbarriers.org



LinkedIn

linkedin.com/in/beyond-barriers-association-44ab40326



MOMENTET KRYESORE



@BBA



Konferenca përmbyllëse dhe Panairi i Ideve në Athinë shënoi përfundimin me sukses të projektit Youth Capacity Building, Action, and Responsibility for the Environment (**Youth-CARE**), duke mbledhur **101 të rinj, përfaqësues të shoqërisë civile dhe palë institucionale** nga vendet partnere. Ngjarja prezantoi nisma mjedisore të drejtuara nga të rinjtë, nxiti shkëmbimin e praktikave të mira dhe theksoi ndikimin e projektit në fuqizimin e të rinjve për të vepruar në drejtim të qëndrueshmërisë mjedisore.

Projekti, i zbatuar nga një partneritet prej pesë organizatash dhe i financuar nga Bashkimi Evropian, **Youth-CARE** arriti mbi 980 pjesëmarrës përmes Trajnimeve të trajnerëve, trajnimeve lokale rinore, iniciativave komunitare dhe tryezave të politikave.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Seminari përfundimtar i projektit CORYA mbi Citizen Science u zhvillua në Tiranë më 4–5 qershor 2025 dhe mbledhi 60 pjesëmarrës, duke e tejkaluar objektivin prej 50 vetash. Ndër pjesëmarrësit kishte përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shkencës dhe Inovacionit, së bashku me studiues të rinj, akademikë dhe punonjës rinie.

Ekspertë nga BBA dhe **Zentrum für Soziale Innovation (ZSI, Austri)**, së bashku me praktikues shqiptarë nga Co-PLAN Institute dhe Milieukontakt Albania, udhëhoqën sesione miqësore për të rinjtë mbi metodologjitë e Citizen Science dhe shembuj praktikë. Eventu përfundoi me **ceremoninë e certifikatave** për ata që përfunduan modulën e-learning të CORYA mbi ORRI dhe Citizen Science.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Ekspozita '[Duart që flasin: Arti dhe trashëgimia në poçeri](#)' shënoi përmbylljen e projektit Art Lab – Trashëgimia në Duart Tona, i zbatuar nga Përtej Barrierave për të fuqizuar të rinjtë me probleme të dëgjimit përmes trajnimit profesional në poçeri dhe qeramikë, duke promovuar njëkohësisht trashëgiminë kulturore shqiptare.

Eventi prezantoi 70 vepra qeramike të punuara me dorë nga 12 pjesëmarrës, së bashku me publikimin e një katalogu digjital dhe shpërndarjen e certifikatave, duke festuar aftësitë, kreativitetin dhe arritjet e tyre.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Inaugurimi i **Interactive Smart Floor** në **Qendrën Burimore 'Luigj Gurakuqi'** në nëntor 2025, ku morën pjesë përfaqësues të Ambasadës Polake në Shqipëri, shënoi përfundimin me sukses të kësaj nisme të zbatuar nga BBA me mbështetjen e programit Polish Aid.

Projekti solli një **mjet inovativ digjital** të të nxënit për fëmijët me **aftësi të kufizuara intelektuale**, duke kombinuar lëvizjen, lojën dhe edukimin për të krijuar një mjedis edukativ më tërheqës dhe gjithëpërfshirës. Inaugurimi shënoi kontributin e projektit në zhvillimin kognitiv, fizik dhe social të fëmijëve përmes të nxënit interaktiv dhe multisensorial.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Ekspozita përfundimtare e Multimedia Hub, e mbajtur në dhjetor 2025, shënoi arritjet e projektit të zbatuar nga Përtej Barrierave me mbështetjen e **Fondacionit Mane** në Qendrën Burimore për Nxënësit që nuk dëgjojnë.

Ekspozita prezantoi **punën kreative** të nxënësve, përfshirë video, fotografi dhe produkte të dizajnit grafik të zhvilluara përgjatë projektit. Ajo theksoi ndikimin e nismës në forcimin e **aftësive digjitale**, **kreativitetit** dhe **vetë-shprehjes**, duke promovuar përfshirjen dhe mundësitë e barabarta përmes edukimit digjital të aksesueshëm.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Pastrimi i përjavshëm i komunitetit është bërë tashmë një traditë në Përtej Barrierave. Çdo të premte, vullnetarët e ESC, së bashku me të rinjtë nga komuniteti lokal, mbledhen për të pastruar hapësirat publike rreth Tiranës, ndërsa rrisin ndërgjegjësimin për **mbrojtjen e mjedisit dhe angazhimin qytetar të përgjegjshëm**.

Ajo që nisi si një nismë e vogël në kuadër të projektit **Youth-CARE**, është shndërruar me kalimin e kohës në një praktikë të qëndrueshme, e përcjellë nga një brez vullnetarësh të tjetri. Sot, kjo nismë përfaqëson angazhimin e vazhdueshëm të BBA-së për promovimin e përgjegjësisë ndaj mjedisit, qytetarisë aktive dhe veprimit komunitar të udhëhequr nga të rinjtë.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Nga 7 deri më 12 prill 2025, Përtej Barrierave bashkëorganizoi **Takimin Ndërrajonal të Pikave të Kontaktit (CPs) dhe Qendrave të Informacionit (ICs)** në Durrës dhe Tiranë, në bashkëpunim me SALTO SEE dhe rrjetin e CP-ve të Ballkanit Perëndimor. Takimi mbledhi përfaqësues të CP-ve, IC-ve dhe Zyrave Kombëtare Erasmus+ (NEO) nga SALTO SEE, SALTO EUROMED dhe SALTO EECA.

Aktiviteti ofroi një platformë për mësim nga njëri-tjetri, rrjetëzim dhe ndërtim kapacitetesh, me synim forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e cilësisë së zbatimit të programeve **Erasmus+ Youth** dhe **European Solidarity Corps (ESC)** nëpër rajone.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Nga 11 deri më 14 tetor 2025, Përtej Barrierave organizoi në Durrës seminarin ndërkombëtar rinor '**Youth on EU Eastern Enlargement**', duke mbledhur mbi 50 të rinj nga **Shqipëria, Spanja, Danimarka dhe Gjeorgjia**.

Përmes punëtorive interaktive, shkëmbimit ndërkulturor dhe dialogut me politikëbërës, pjesëmarrësit eksploruan rolin e të rinjve në procesin e integritimit në BE të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor, me fokus te demokracia, lufta kundër dezinformimit dhe qytetaria aktive. Eventu u implementua në partneritet me **JEF Danimarkën, JEF Spanjën, JEF Gjeorgjinë, dhe JEF në Shqipëri** duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe angazhimin e të rinjve në formësimin e së ardhmes së Evropës.

@BBA



Ky partneritet forcon BBA-në me rrjetet ndërkombëtare ndërkohë që promovon **shkëmbime ndërkulturore**, mësimet praktike, dhe bashkëpunimin e organizatës me institucionet lokale.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



BBA e zgjeroi programin e saj të vullnetarizmit të Korpunit Evropian të Solidaritetit duke hapur **vendosje të reja vullnetarësh në Korçë dhe Sarandë**. Si pjesë e këtij zgjerimi, organizata priti grupin e parë prej tetë vullnetarësh afatshkurtër nga Franca.

Gjatë mobilitetit të tyre, vullnetarët kontribuan **në aktivitete edukative, sociale, mjedisore dhe komunitare** të zbatuara në bashkëpunim me partnerët lokalë. Pjesëmarrja e tyre e pasuroi programin me anë të shkëmbimeve ndërkulturore, angazhimit aktiv në komunitet, dhe promovimit të **vlerave Europiane të solidaritetit, gjithëpërfshirjes dhe qytetarisë aktive**.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Në kuadër të aktiviteteve për Ditën Kombëtare të Rinisë 2025, Shoqata Përtej Barrierave mori pjesë si partnere në eventin **“Rrugët e rinisë 2030”**, të organizuar nga *Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit* në Piramidën e Tiranës.

BBA angazhoi të rinjtë përmes një stende informuese për promovimin e Korpusit Evropian të Solidaritetit, një workshop-i kreativ ArtLab, si dhe një sesioni informues mbi mundësitë e programit Erasmus+, në rolin e saj si Pikë Kombëtare Kontakti për programet Erasmus+ Youth dhe ESC në Shqipëri. Aktiviteti kontribui në rritjen e informimit dhe **përfshirjes së të rinjve**, duke promovuar pjesëmarrjen aktive, mobilitetin ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirjen.

MOMENTET KRYESORE



@BBA



Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, vullnetarët ndërkombëtarë të ESC-së të Përtej Barrierave ishin të pranishëm çdo ditë në Sheshin Skënderbej gjatë verës, duke mbështetur aktivitetet e qendrës rinore lëvizëse.

Duke punuar nga një minibuz i përshtatur posaçërisht, ata ndihmuan kalimtarët gjatë ditëve të nxehta të verës duke ofruar informacion, orientim dhe ndihmë bazë shëndetësore, ndërsa ndihmonin në krijimin e një hapësire mikpritëse dhe të aksesueshme për komunitetin lokal.

MOMENTET KRYESORE




Gjatë vitit 2025, BBA dërgoi **60 pjesëmarrës** jashtë vendit në kuadër të **15 projekteve ndërkombëtare** të mobilitetit, të zhvilluara në **12 shtete**, përfshirë Spanjën, Gjermaninë, Italinë, Kroacinë, Rumaninë, Francën, Belgjikën, Serbinë, Gjeorgjinë, Greqinë, Poloninë dhe Slloveninë.

Aktivitetet përfshijnë seminare, vizita studimore, shkëmbime rinore, kurse trajnimi për punonjës rinorë dhe konferenca rinore, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të BBA-së në rrjetet evropiane rinore dhe në tema të tilla si mirëqenia digjitale, gjithëpërfshirja, feminizmi, veprimi mjedisor dhe fuqizimi i kapaciteteve në fushën e vullnetarizmit.



PUBLIKIMET



Ky **Indeks Rajonal**, i zhvilluar në kuadër të projektit "Stronger Voices for Better Choices – Youth Hub for the Western Balkans and Turkey", është një raport gjithëpërfshirës monitorimi që analizon pjesëmarrjen **politike, ekonomike dhe sociale të të rinjve** (15–29 vjeç) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, përfshirë Shqipërinë. Ai thekson sfida të vazhdueshme si përfaqësimi i ulët rinor dhe papunësia, së bashku me rekomandime konkrete për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për të rinjtë dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje.

[Youth Participation Index 2023](#)



Kjo **Përmbledhje Politikash**, e zhvilluar në kuadër të projektit "Stronger Voices for Better Choices – Youth Hub for the Western Balkans and Turkey", bazohet në Indeks të Pjesëmarrjes Rinore për Shqipërinë 2023.

Ajo fokusohet në forcimin dhe funksionalizimin e **Këshillave Vendorë Rinorë** si mekanizma kyç për pjesëmarrjen rinore në vendimmarrjen lokale.

[Policy Brief](#)

PUBLIKIMET



Ky **Raport Kombëtar Monitorimi**, i prezantuar nga Përtej Barrierave në bashkëpunim me Partners Albania në kuadër të projektit "Stronger Voices for Better Choices – Youth Hub for the Western Balkans and Turkey", analizon pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri në vitin 2024.

Ai tregon progres pozitiv në punësimin dhe arsimimin e të rinjve, duke identifikuar njëkohësisht sfida të vazhdueshme si përfaqësimi i kufizuar politik dhe pabarazitë gjinore, duke ofruar një mjet të bazuar në të dhëna për të informuar politika më gjithëpërfshirëse rinore.


Monitoring Report 2024



Kjo **Kurrikul për Edukimin Mediatik**, teksti mësimor dhe materialet shoqëruese edukative, përfshirë edhe kuize, u zhvilluan në kuadër të projektit MEDIAActive Youth. Materialet janë të disponueshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e organizatave partnere, duke mbështetur një të nxënë të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirëse mbi edukimin mediatik për të rinjtë në vendet pjesëmarrëse.


Sorting Facts from Fiction – Textbook and Curriculum

KURSE TË REJA TË MËSIMIT ELEKTRONIK



Në vitin 2025, BBA zhvilloi një **kurs dygjuhësh e-learning** mbi Kërkimin dhe Inovacionin e Hapur dhe të Përgjegjshëm (ORRI) dhe Shkencën Qytetare në kuadër të projektit CORYA. Përmes shtatë mësimëve, detyrave interaktive dhe shembujve praktikë, ky kurs në **Aktivizon.al** ndihmon kërkuesit e rinj, punonjësit rinorë dhe aktorët e shoqërisë civile të kuptojnë dhe zbatojnë qasje kërkimore gjithëpërfshirëse, etike dhe pjesëmarrëse. Kursi u krijua në kuadër të projektit CORYA, i zbatuar nga BBA dhe ZSI në kuadër të nismës REINFORCING, të financuar nga BE.

Gjeni kursin këtu, të disponueshëm në gjuhën angleze dhe shqipe



[Find the course here](#)

Në vitin 2025, BBA kontribuoi në zhvillimin e kursit e-learning "Sorting Facts from Fiction", krijuar në kuadër të projektit Erasmus+ MEDIAActive Youth: Informing the Balkans. Kursi mbështet të rinjtë dhe punonjësit rinorë në forcimin e mendimit kritik, alfabetizimit mbi lajmet dhe aftësive për verifikimin e fakteve, me fokus tek dezinformimi, propaganda, media digjitale dhe pjesëmarrja e përgjegjshme online.

Projektet Ndërkombëtare

STRONGER VOICES FOR BETTER CHOICES- A YOUTH HUB IN THE WESTERN BALKAN AND TURKEY

Stronger Voices for Better Choices – A Youth Hub in the Western Balkans and Türkiye është një projekt rajonal i zbatuar nga Shoqata Përtej Barrierave në Shqipëri për të forcuar pjesëmarrjen rinore në proceset demokratike përmes avokimit të bazuar në prova, reformës së politikave dhe ndërtimit të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile. Projekti promovon angazhim kuptimplotë rinor në vendimmarrje përmes zhvillimit të Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore (YPI), prodhimit të rekomandimeve të politikave, forcimit të rrjeteve të Qendrave Rinore, dhe nxitjes së bashkëpunimit mes të rinjve, shoqërisë civile dhe institucioneve publike në nivel lokal dhe kombëtar.

Aktivitetet

Gjatë vitit 2025, Shoqata Përtej Barrierave organizoi lançimin kombëtar të Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore 2023 me 145 pjesëmarrës, lehtësoi 1 debat konsultativ kombëtar me 22 aktorë, zhvilloi 5 takime avokimi me pjesëmarrjen e 62 personave, lançoi 1 thirrje kombëtare për propozime që rezultoi në financimin e 8 OSHC-ve, dhe zbatoi fushatën ndërgjegjëse "Java e Pjesëmarrjes Rinore", duke arritur mbi 19,000 persona në të gjithë Shqipërinë. Në total, aktivitetet e projektit angazhuan drejtpërdrejt 231 pjesëmarrës, përfshirë të rinj, institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe autoritete lokale.



7 evente kombëtare të zbatuara



8 OSHC të përzgjedhura dhe financuara



Fushata "Java e Pjesëmarrjes Rinore"



GALERI FOTOSH



Projektet Ndërkombëtare

YOUTH CARE

Projekti Youth-CARE (Ndërtimi i Kapaciteteve, Veprimi dhe Përgjegjësia e të Rinjve për Mjedisin) është një përpjekje e përbashkët e pesë organizatave të shoqërisë civile: Shoqata Përtej Barrierave (koordinatore, Shqipëri), TDM2000 International (Itali), The Door Organization (Shqipëri), ANCE (Greqi) dhe MES (Mal i Zi). I financuar nga Bashkimi Evropian, Youth-CARE fokusohet në fuqizimin e të rinjve, veçanërisht atyre që jetojnë në zona të disavantazuara, për të kuptuar sfidat mjedisore dhe për të kontribuar aktivisht në mbrojtjen e mjedisit përmes edukimit joformal.



Aktivitetet

Në vitin 2025, projekti zbatoi 4 Trajnime Kombëtare të Trajnerëve me pjesëmarrjen e 67 personave, 6 trajnime lokale për të rinj me pjesëmarrjen e 236 personave, dhe një seri nismash të udhëhequra nga të rinjtë që arritën 529 të rinj në komunitete të ndryshme, të pasuara nga 4 tryeza të rrumbullakëta me 55 pjesëmarrës nga të rinjtë dhe institucionet, dhe u përmbyll me 1 Konferencë Përfundimtare rajonale dhe Panair Idesh me 101 pjesëmarrës, duke siguruar angazhim të fortë në të gjitha nivelet e zbatimit.

➤ 4 TOT kombëtare

➤ 6 trajnime lokale

➤ 4 tryeza të rrumbullakëta kombëtare



GALERI FOTOSH



Projektet Ndërkombëtare

PERMAYOUTH

PERMAYOUTH: Sustainable Youth and Permaculture Practices është një projekt 36-mujor i financuar nga programi Erasmus+, i cili bashkon partnerë nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova dhe Serbia për të promovuar bujqësinë e qëndrueshme dhe praktikën e permakulturës mes të rinjve.

I koordinuar nga IOM Maqedonia e Veriut, projekti ndërthur të mësuarit online me aktivitete praktike në nivel lokal, me synimin për të zhvilluar aftësi të gjelbra, për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e komuniteteve.

Përmes gjashtë kurseve virtuale të trajnimit, broshurave edukative, video-leksioneve dhe aktiviteteve praktike në secilin vend, projekti u mundëson pjesëmarrësve që njohuritë e fituara t'i zbatojnë në kontekste reale. Aktivitetet e vazhdueshme të komunikimit dhe shpërndarjes së rezultateve, së bashku me përdorimin e mjeteve digjitale, sigurojnë një shtrirje të gjerë dhe ndikim afatgjatë, duke i bërë rezultatet të aksesueshme edhe pas përfundimit të projektit.

Aktivitetet


Në vitin 2025, Shoqata Përtej Barrierave mirëpriti takimin hapës të projektit PERMAYOUTH – Sustainable Youth and Permaculture Practices, i cili u lançua zyrtarisht më 6 qershor. I financuar nga programi Erasmus+ dhe i udhëhequr nga IOY – Maqedonia e Veriut, takimi mbledhi partnerë nga Shqipëria, Serbia dhe Kosova për të harmonizuar objektivat e projektit, rolet e partnerëve dhe aktivitetet e ardhshme.

Takimi shënoi fillimin e një përpjekjeje rajonale për promovimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe praktikave të permakulturës, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin e aftësive të të rinjve, rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe forcimin e angazhimit në komunitet.

Zbatimi i pjesës tjetër të aktiviteteve të projektit është planifikuar të fillojë në 2026.



GALERI FOTOSH



Projektet Ndërkombëtare

CORYA

CORYA ("Kërkim Bashkëpunues, i Hapur dhe i Përgjegjshëm mbi Angazhimin Rinor në Shqipëri") është një projekt i nën-financuar nga Thirrja e Parë e Inkubatorit të projektit REINFORCING, në kuadër të Programit "HORIZON-WIDERA-2022-ERA-01-40". Qëllimi i CORYA-s është të prezantojë ORRI dhe Shkencën Qytetare tek kërkuesit e rinj, të forcojë angazhimin e të rinjve në kërkim dhe inovacion, dhe të nxisë bashkëpunimin mes aktorëve kyç në Shqipëri.

Projekti u zbatua për një periudhë 1-vjeçare, shtator 2024 – gusht 2025, nga BBA në Shqipëri dhe Zentrum für Soziale Innovation GmbH – ZSI, në Vjenë, Austri.

Aktivitetet

Në vitin 2025, CORYA kaloi nga faza e ngritjes së bazave të projektit në zbatimin e plotë të aktiviteteve. Në platformën Aktivizon.al u lançua një modul dygjuhësh e-learning mbi ORRI dhe Citizen Science, i cili tërhoqi 131 aplikime dhe certifikoi 50 pjesëmarrës.

Projekti organizoi gjithashtu një Takim Kombëtar të Aktorëve të Interesit në Tiranë, me pjesëmarrjen e 18 përfaqësuesve nga academia, shoqëria civile, biznesi dhe institucionet publike, si dhe katër workshop-e universitare që përfshinë 85 studentë dhe përfaqësues të akademisë.

CORYA u përmbyll me një Seminar Final dyditor mbi Citizen Science, i cili mbledhi 60 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësues të institucioneve kryesore kombëtare, kërkues të rinj, akademikë dhe punonjës rinorë.

➤ 50 të diplomuar në kursin e-learning

➤ 60 pjesëmarrës në Seminarin Përfundimtar

➤ 85 studentë universitarë të arritur



GALERI FOTOSH



Projektet Kombëtare

RYDE – ZË DHE NDIKIM: FUQIZIMI I KËSHILLAVE RINORË PËR NDRYSHIM NË KOMUNITET

Voice and Impact – Fuqizim i këshillave rinorë për ndryshim në komunitet është një projekt i zbatuar nga Shoqata Përtej Barrierave në kuadër të programit Regional Youth Dialogue for Europe (RYDE). Projekti synon të forcojë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen lokale përmes ngritjes së kapaciteteve të Këshillave Vendorë Rinorë në bashkitë Ersekë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Tepelenë.

Përmes aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve, dialogut me autoritetet vendore dhe planifikimit me pjesëmarrje, projekti fuqizon të rinjtë që të advokojnë për nevojat e tyre, të kontribuojnë në hartimin e politikave lokale dhe të promovojnë një qeverisje gjithëpërfshirëse dhe demokratike në nivel vendor.

Aktivitetet

Gjatë vitit 2025, Shoqata Përtej Barrierave organizoi një Kamp Trajnimi (ACTivate Bootcamp) për 21 përfaqësues të rinj, lehtësoi zhvillimin e katër Planeve Vendore të Veprimit Rinor bazuar në konsultime me mbi 100 të rinj dhe aktorë lokalë, zhvilloi tre forume publike dhe katër takime avokimi me autoritetet vendore për të promovuar miratimin e Planeve të Veprimit, dhe zbatoi një fushatë ndërgjegjësimi gjashtëmujore përmes rrjeteve sociale dhe komunikimit online. Gjatë këtyre aktiviteteve, morën pjesë më shumë se 220 të rinj, përfaqësues bashkiakë, edukatorë dhe palë të interesuara të komunitetit, duke kontribuar në një angazhim dhe bashkëpunim më të fortë të të rinjve midis autoriteteve lokale dhe Këshillave Rinore.

- 226 pjesëmarrës
- 8 trajnime/takime avokimi/forume publike
- 4 Plane Veprimi të zhvilluara



GALERI FOTOSH



Projektet Kombëtare

MEDIActive Youth

MEDIActive Youth është një projekt ndërkombëtar i dedikuar forcimit të edukimit mediatik, edukimit mbi lajmet, mendimit kritik dhe rezistencës ndaj dezinformimit mes të rinjve dhe punonjësve rinorë në Ballkanin Perëndimor. Objektivi i tij kryesor është të pajisë pjesëmarrësit me njohuritë, aftësitë dhe mjetet praktike për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin, për të identifikuar dezinformatat dhe propagandën, për të promovuar angazhimin e përgjegjshëm në media dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive demokratike. Projekti zbatohet gjatë një periudhe dyvjeçare, nga marsi 2024 deri në mars 2026, dhe bashkon organizatat partnere nga i gjithë Ballkani Perëndimor për të zhvilluar burime inovative arsimore, për të forcuar kapacitetet e punonjësve të të rinjve dhe për të promovuar njohuritë mediatike përmes bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të njohurive.

Aktivitetet

Projekti u përqendrua në zhvillimin, testimin dhe shpërndarjen e materialeve edukative të krijuara në kuadër të tij. Paketa e Materialeve Mësimore (TMP) dhe kursi online MOOC “Sorting Facts from Fiction” u finalizuan, duke përfshirë 15 mësimet të strukturuar në Moodle, të pasuruara me prezantime, video origjinale, kuize dhe ushtrime praktike.

U organizua gjithashtu një kurs pilot trajnimi për të testuar kurrikulën e sapozhvilluar dhe materialet e të mësuarit online, duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë të ofronin komente dhe sugjerime përpara shpërndarjes së tyre më të gjerë.

Në të njëjtën kohë, të rinjtë shqiptarë kontribuan aktivisht në Transnational Youth Magazine (TYM) përmes shkrimit dhe publikimit të artikujve mbi edukimin mediatik, pjesëmarrjen rinore, vlerat demokratike dhe çështje aktuale sociale, duke forcuar aftësitë e tyre në të menduarit kritik, shkrim dhe prodhim mediatik.

- Finalizimi i TMP dhe MOOC
- 10 artikuj të shkruar nga të rinjtë tanë
- 1 kurs pilot trajnimi



GALERI FOTOSH



Projektet Lokale

ARTLAB - TRASHEGIMIA NE DUART TONA

Art Lab – Trashëgimia në Duart Tona u zbatua nga Shoqata Përtej Barrierave me synimin për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore shqiptare, duke fuqizuar njëkohësisht të rinjtë me probleme në dëgjim përmes formimit profesional në fushën e poçerisë dhe qeramikës.

Projekti ndërthuri mjeshtërinë tradicionale me edukimin gjithëpërfshirës, duke u ofruar pjesëmarrësve aftësi praktike artistike dhe profesionale, duke nxitur përfshirjen e tyre sociale dhe mundësitë për punësim, si dhe duke krijuar hapësira që ata të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë artizanale shqiptare.

Aktivitetet

Gjatë vitit 2025, projekti krijoi dhe zbatoi një program të strukturuar trajnimi në poçeri, qeramikë, motive gipsi dhe teknika dekorative për 12 të rinj me dëmtime të dëgjimit nga Qendra Burimore për Nxënës të që nuk Dëgjojnë. U organizuan mbi 25 sesione trajnimi dhe mentorimi praktik mes majit dhe gushtit, të ndjekura nga prodhimi individual i objekteve të punuara me dorë. Projekti u përmyll me ekspozitën publike "Duart që Flasin: Arti dhe Trashëgimia në Poçeri", ku u ekspozuan 70 produkte qeramike të punuara me dorë, të krijuara nga pjesëmarrësit, së bashku me publikimin e një katalogu dixhital dhe dhënien e certifikatave që njihnin aftësitë profesionale të fituara rishtazi nga pjesëmarrësit.

➤ *26 sesione trajnimi dhe mentorimi*

➤ *12 të rinj me probleme në dëgjim*

➤ *Mbi 70 produkte qeramike dhe artizanale të punuara me dorë*



GALERI FOTOSH



Projektet Lokale

MULTIMEDIA HUB

Projekti Multimedia Hub u zbatua nga shtatori deri në dhjetor 2025 në Shqipëri nga Shoqata Përtej Barrierave, me mbështetjen e Fondacionit Mane, pranë Qendrës Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë. Projekti u konceptua për t'iu përgjigjur nevojës për edukim digjital gjithëpërfshirës, duke krijuar një hapësirë të aksesueshme ku nxënësit që nuk dëgjojnë mund të zhvillojnë aftësi në multimedia, komunikim dhe krijimtari. Objektivi kryesor ishte fuqizimi i nxënësve përmes edukimit digjital, tregimit vizual dhe praninë e përgjegjshme online, duke promovuar njëkohësisht gjithëpërfshirjen dhe mundësitë e barabarta.

Për realizimin e këtij objekti, projekti krijoi dhe pajisi një Multimedia Hub, zhvilloi 36 orë trajnimi gjatë 12 ditëve, si dhe organizoi workshop-e praktike, sesione për krijimin e përmbajtjes digjitale, ditë tematike mbi qytetarinë digjitale dhe një ekspozitë përmbyllëse. Në total, 37 nxënës u përfshinë drejtpërdrejt në trajnime dhe aktivitete, ndërsa 83 nxënës përfituan në tërësi nga hapësira dhe materialet e krijuara.

Si rezultat, pjesëmarrësit krijuan 8 video, mbi 100 fotografi dhe 30 postera, duke fituar aftësi praktike dhe më shumë vetëbesim për të shprehur veten dhe për të marrë pjesë në mënyrë më aktive në shoqëri.




**83 nxënës me
probleme në dëgjim**



**12 trajnime të
zhvilluara**



**138 materiale
audiovizuale të
prodhuara nga nxënësit**



GALERI FOTOSH



Projektet Lokale

INTERACTIVE SMART FLOOR

Nisma e Interactive Smart Floor u zbatua në Qendrën Burimore "Luigj Gurakuqi" në Shqipëri nga Shoqata Përtej Barrierave, me mbështetjen e Ambasadës së Polonisë në Shqipëri përmes programit Polish Aid. Projekti u dizajnuar për t'iu përgjigjur nevojës për mjete mësimore më gjithëpërfshirëse, tërheqëse dhe adaptive për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale. Objektivi i tij kryesor ishte të përmirësonte të nxënit përmes aktiviteteve të bazuara në lëvizje dhe shumëshqisore, duke mbështetur zhvillimin kognitiv, fizik dhe social të fëmijëve në një mënyrë interaktive.

Për ta arritur këtë, një dysHEME interaktive inteligjente u prezantua si mjet mësimor digjital, duke u mundësuar fëmijëve të mësojnë përmes lojës, aktivitetit fizik dhe stimulimit vizual. Aktivitetet u përqendruan në kombinimin e edukimit dhe lëvizjes, duke e bërë procesin e të nxënit më dinamik, të arritshëm dhe të këndshëm.

Si rezultat, fëmijët u angazhuan aktivisht në ushtrime interaktive që përmirësuan vëmendjen, koordinimin dhe pjesëmarrjen, while creating a more motivating and empowering learning environment.




**80 nxënës me aftësi
të kufizuara
intelektuale të
përfitur**



**7 mësues të
trajnuar**



**1 event
inaugurimi i
zbatuar**



GALERI FOTOSH



Pika e Kontaktit

ROLI I PIKËS SË KONTAKTIT

Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit për programet Erasmus+ dhe ESC (ish-EVS) në Shqipëri që nga viti 2011. Si e tillë, BBA ka mision të mbështesë organizatat dhe individët e interesuar për të organizuar projekte në kuadër të programit Erasmus+, fushës rinore, dhe Korpusit Evropian të Solidaritetit. Për këtë qëllim, ne ofrojmë informacion dhe këshillim dhe zhvillojmë aktivitete të synuara informimi dhe trajnimi me mbështetjen e SALTO SEE.

AKTIVITETET E ZBATUARA NË KUADËR TË ROLIT TË PK PËR E+ & ESC

Mentorim Peer-to-Peer me Organizata të Akredituara të ESC-së

Mentorimi peer-to-peer mbështeti organizatat e akredituara të ESC-së përmes sesioneve të rregullta, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të synuar të kapaciteteve, duke forcuar menaxhimin e projekteve, sistemet e mbështetjes vullnetare dhe cilësinë e përgjithshme të zbatimit të ESC-së.

➤ Online, gjatë gjithë vitit 2025 (e përsëritur)

➤ 10 organizata

Sesion Informues – Erasmus+ CBY, Njihuni me Thirrjen e Re për 2026

Një sesion informues i dha organizatave një pamje të parë të Thirrjes për Propozime Erasmus+ 2026, duke mbuluar aktivitete të pranueshme, procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, për të ndihmuar në aplikimin më të fortë të KA2.

➤ Tiranë (Piramida e Tiranës), 8 dhjetor 2025

➤ 31 pjesëmarrës nga 11 organizata plus studentë universitarë

Erasmus+ CBY – Shkrimi i Projekteve Cilësore (Udhëzuesi 2026)

Një trajnim dyditor forcoi aftësinë e pjesëmarrësve për të zhvilluar dhe dorëzuar aplikime projektesh Erasmus+ KA2, duke mbuluar platformën e aplikimit, buxhetimin, dokumentacionin dhe praktikën më të mira.

➤ Tiranë (Biblioteka Misto Treska), 11–12 dhjetor 2025

➤ 15 pjesëmarrës nga 10 organizata nga 6 qytete të Shqipërisë

Pika e Kontaktit

Festojmë Ditët e Erasmus! – Fushatë Online dhe Ditë e Hapur

Një fushatë ndërgjegjësimi online e kombinuar me një Ditë të Hapur lidhi të rinjtë me alumni të Erasmus+ dhe ESC-së dhe vullnetarë ndërkombëtarë, të cilët ndanë përvojat e tyre dhe ofruan udhëzime.

➤ Tiranë (zyra e BBA-së dhe Europe House) / online, 16–17 tetor 2025

➤ 63 pjesëmarrës në 2 aktivitete fizike; mbi 1,000 llogari të arritura online

Ditë Konsultimi të Hapura E+ & ESC

Konsultime javore individuale u dhanë punonjësve rinorë, koordinatorëve të projekteve dhe përfaqësuesve institucionalë udhëzime të përshtatura në të gjitha fazat e zbatimit të projekteve Erasmus+ dhe ESC.

➤ Tiranë / Korçë / Sarandë / online, gjatë gjithë vitit 2025 (i përsëritur)

➤ Mbi 40 përfitues gjatë vitit

Promovim Online i E+ dhe ESC

Një fushatë e vazhdueshme mediatike dhe në rrjete sociale, e udhëhequr nga vullnetarët e ESC-së, ndau dëshmi dhe informacione praktike për të ndërgjegjësuar mbi mundësitë e Erasmus+ dhe ESC, me fokusin në zonat rurale.

➤ Online, gjatë gjithë vitit 2025 (i përsëritur)

➤ Mbi 70,000 shikime në website, Facebook dhe Instagram

Prepare to Succeed – Trajnim i Thelluar Erasmus+ KA2

BBA mbështeti trajnimin rajonal të SALTO SEE për organizatat e Ballkanit Perëndimor mbi kuadrin Erasmus+ KA2, procedurat e aplikimit, buxhetimin dhe ndërtimin e partneriteteve.

➤ Online, 5–6 shkurt 2025

➤ 40 pjesëmarrës

Takimi Ndërrajonal i Pikave të Kontaktit dhe Qendrave të Informimit

BBA organizoi së bashku një takim rajonal të Pikave të Kontaktit, Qendrave të Informimit dhe Zyrave Kombëtare të Erasmus+ për mësim ndërmjet kolegëve, vizita studimore dhe dialog mbi forcimin e zbatimit të Erasmus+ dhe ESC.

➤ Durrës dhe Tiranë, 7–12 prill 2025

➤ 30 pjesëmarrës nga Ballkani Perëndimor, Mesdheu Jugor dhe Evropa Lindore/Kaukazi

Aktivitete Promovuese në Institucionet Arsimore

Sesione informuese në shkolla të mesme dhe universitete me vullnetarë të ESC-së që ndanë përvoja personale për të ndërgjegjësuar mbi mundësitë e Erasmus+ dhe ESC mes studentëve.

➤ Tiranë, Korçë dhe Sarandë (shkolla dhe universitete), gjatë gjithë vitit 2025 (i përsëritur)

➤ Mbi 100 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë universitarë



GALERI FOTOSH



ESC (Roli Pritës)

Vullnetarizëm që forcon komunitetet

Në vitin 2025, Shoqata Përtej Barrierave priti 85 vullnetarë të Korpusit Evropian të Solidaritetit përmes aktiviteteve vullnetare afatgjata, afatshkurtra dhe ekipore. Të mbështetur nga koordinatore, mentorë dhe profesionistë lokalë të BBA-së, vullnetarët kontribuan në programe edukative, sociale, mjedisore dhe komunitare.

Pjesëmarrja e tyre solli ide të reja, energji dhe perspektiva ndërkulturore në punën e BBA-së, duke ofruar njëkohësisht mundësi kuptimplota për të mësuar, zhvilluar aftësi dhe angazhuar me komunitetin lokal.

Puna rinore, edukimi joformal dhe të mësuarit ndërkulturor

Në bashkëpunim me partnerë lokalë, përfshirë TEN Center dhe Qendrën e Lëvizshme Rinore, vullnetarët lehtësuan sesione gjuhësore dhe kulturore, punëtori krijuese, lojëra edukative, diskutime dhe aktivitete ekipore.

Ata u inkurajuan gjithashtu të zhvillonin nisma bazuar në interesat dhe aftësitë e tyre. Përmes mbrëmjeve ndërkulturore dhe prezantimeve, të rinjtë lokalë zbuluan kultura dhe tradita të reja, ndërsa vullnetarët fituan një kuptim më të thellë të shoqërisë shqiptare.

Edukim dhe aktivitete gjithëpërfshirëse me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara

Një pjesë kyçe e programit u fokusua në mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

Në Qendrën Burimore "Luigj Gurakuqi", vullnetarët ndihmuan me lojëra edukative, punëtori krijuese, sporte, kopshtari, aktivitete në serë dhe mësim interaktiv përmes Dyshemesë Inteligjente.

Në Qendrën Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë, ata mbështetën punëtori qeramike dhe modelimi të lidhura me ArtLab, së bashku me aktivitete rekreative, artistike dhe sociale. Duke punuar me staf të specializuar, vullnetarët ndihmuan në krijimin e hapësirave gjithëpërfshirëse ku fëmijët mund të shpreheshin, të zhvillonin aftësi dhe të merrnin pjesë me besim.

Komunikimi dhe promovimi i mundësive evropiane

Vullnetarët dokumentuan dhe promovuan punën e BBA-së përmes fotografive, videove, intervistave, reels dhe përmbajtjes në rrjete sociale, duke ndarë përvojat dhe reflektimet e tyre mbi vullnetarizmin në Shqipëri. Ata gjithashtu morën pjesë në vizita shkollore dhe universitare, sesione informuese, aktivitete të Ditëve të Erasmus dhe ngjarje publike. Duke ndarë histori personale, ata ndihmuan që mundësitë e Erasmus+ dhe ESC të jenë më të arritshme dhe të lidhura me të rinjtë shqiptarë.

ESC (Roli Pritës)

ZGJERIMI I VULLNETARIZMIT ESC NË TË GJITHË SHQIPËRINË

Në vitin 2025, BBA zgjeroi akreditimin e saj të Korpusit Evropian të Solidaritetit përtej Tiranës, duke marrë akreditim për të pritur vullnetarë në Korçë, Sarandë, Tepelenë dhe Gjirokastrë. Ky zgjerim sjell mundësitë evropiane më afër komuniteteve jashtë kryeqytetit dhe u mundëson vullnetarëve të kontribuojnë në nisma lokale, duke përjetuar njëkohësisht diversitetin kulturor dhe social të Shqipërisë.

Mobilitetet e para të ESC-së në Korçë dhe Sarandë

BBA priti mobilitetet e para të ESC-së në Korçë dhe Sarandë, me pjesëmarrjen e tetë vullnetarëve afatshkurtër nga Franca. Në bashkëpunim me partnerët lokalë, ata mbështetën aktivitete edukative, sociale, mjedisore dhe ndërkulturore me fëmijë dhe të rinj. Këto mobilitete demonstruan se aktivitete vullnetare cilësore mund të zbatohen me sukses edhe jashtë Tiranës dhe krijuan një bazë të fortë për vendosje të ardhshme në Tepelenë dhe Gjirokastrë.

ILIVE – Të Mësuarit Gjithëpërfshirës në Përvojat e Vullnetarizmit (VTHPA)

Në vitin 2025, BBA priti një ekip vullnetar ndërkombëtar në Tiranë përmes projektit ILIVE, në kuadër të programit Ekipet Vullnetare në Zona me Prioritet të Lartë. Vullnetarë nga Shqipëria, Spanja dhe Turqia eksploruan vullnetarizmin, sportin dhe përfshirjen e të rinjve me aftësi të kufizuara përmes punësorive, aktiviteteve ndërkulturore dhe përvojave praktike vullnetare. Projekti promovoi organizata sportive më gjithëpërfshirëse dhe theksoi rolet e larmishme që mund të luajnë vullnetarët, duke përfshirë komunikimin, shtrirjen e aktiviteteve, organizimin e eventeve dhe mbështetjen logjistike.

Kontributi i vullnetarëve tanë

Vullnetarët e ESC-së forcuan kapacitetin e BBA-së për të mbështetur fëmijët, të rinjtë dhe institucionet lokale, duke sjellë kreativitet, diversitet dhe të mësuar ndërkulturor në programet e saj. Përmes përfshirjes së tyre, vullnetarët zhvilluan aftësi në komunikim, punë ekipore, udhëheqje, adaptueshmëri, planifikim aktivitesh dhe edukim joformal. Së bashku, ata e shndërruan solidaritetin evropian në veprim kuptimplotë lokal dhe u bënë një pjesë e rëndësishme e punës së BBA-së gjatë gjithë vitit 2025.



GALERI FOTOSH



ESC (Roli Mbështetës)

MILJANA KAJO

Titulli i projektit: Ndrysho mbështetjen vullnetare

Kohëzgjatja: 23/06/2025 – 22/04/2026

Vendndodhja: Brescia, Itali

Organizata pritëse: CSV Brescia ETS

Përshkrimi i aktiviteteve: Miljana mbështeti aktivitetet e përditshme të CSV Brescia, duke kontribuar në fushatat e komunikimit, përmbajtjen e mediave sociale dhe promovimin e vullnetarizmit në shkolla, qendra rinore dhe evente publike. Ajo gjithashtu ndihmoi me sportelin lokal të informacionit për vullnetarizmin, mbështeti zhvillimin e projekteve evropiane dhe lokale dhe mori pjesë në punëtori dhe evente komunitare që promovonin përfshirjen, dialogun ndërkulturor, pjesëmarrjen e të rinjve dhe qëndrueshmërinë.

SINDI BEQIRAJ

Titulli i projektit: Vullnetarizmi me S&G

Kohëzgjatja: 21/07/2025 – 20/09/2025

Vendndodhja: Ankara, Turqi

Organizata pritëse: System and Generation Association (S&G)

Përshkrimi i aktiviteteve: Sindi mbështeti punën e përditshme të organizatës përmes zhvillimit të projekteve, përgatitjes së eventeve, komunikimit, menaxhimit të mediave sociale dhe aktiviteteve të rrjetëzimit. Ajo gjithashtu kontriboi në iniciativat e komunitetit që përfshinin refugjatët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe shkollat, duke promovuar njëkohësisht ndërgjegjësimin mjedisor.

EMI KALLUCI

Titulli i projektit: Mbështetja e Kohezionit Ndërkulturor dhe Zhvillimit Lokal në Guianën Franceze

Kohëzgjatja: 11/11/2025 – 11/12/2025

Vendndodhja: Cayenne, Guiana Franceze

Organizata pritëse: Peupl'en Harmonie

Përshkrimi i aktiviteteve: Emi mbështeti përgatitjen dhe organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunitetit, kontriboi në menaxhimin e mediave sociale dhe krijimin e materialeve promovuese, si dhe ndihmoi në promovimin e programeve evropiane. Ajo gjithashtu bashkë-lehtësoi mësimet e anglishtes për të rinjtë vendas, duke kontribuar në të nxënit ndërkulturor dhe angazhimin e komunitetit.



GALERI FOTOSH



F A L E M I N D E R I T !



RRUGA 'HYSNI GERBOLLI', PALLATET ARDARO, HYRJA 1, KATI 1



WWW.BEYONDBARRIERS.ORG